

PËRMBLEDHJE

Gjatë vizitës së vitit 2015 që u zhvillua mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2004 midis Këshillit të Evropës dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, delegacioni i KPT-së shqyrtoi masat e marra nga autoritetet përkatëse, në vijim të rekomandimeve të bëra nga Komiteti pas vizitave të tij të mëparshme (në 2007 dhe 2010). Në lidhje me këtë, vëmendje e posaçme iu kushtua trajtimit dhe kushteve të ndalimit të personave në komisariatet e policisë dhe situates në institucionet e vuajtjes së dënimit si dhe në Institutin e Psikiatrisë Ligjore në Spitalin Universitar të Prishtinës.

Përgjatë vizitës, delegacioni pati bashkëpunim shumë të mirë në të gjitha nivelet. Atij iu lejua hyrje e shpejtë në të gjitha vendet e vizituara (përfshi edhe ato që nuk ishin njoftuar paraprakisht), iu sigurua informacioni i nevojshëm për të përmbushur detyrën e tij dhe pati mundësi të fliste privatisht me personat të cilëve iu ishte hequr liria.

Komisariatet e policisë

Delegacioni krijoi përshtypjen që krahasuar me vitin 2010, situata e përgjithshme ishte përmirësuar disi, qoftë për nga numri ashtu edhe për nga përkatësitë akuzave serioze për keqtrajtim nga policia. Megjithatë, delegacionit iu paraqitën nga persona të ndaluar një numër i konsiderueshëm akuzash për keqtrajtim fizik nga oficerët e policisë. Shumica e akuzave kishte të bënte me goditje me shpulla, grushte dhe shkelma gjatë marrjes në pyetje nga policia me qëllim marrjen e deklaratave ose gjatë kohës së arrestimit, pasi personi i përfshirë ishte vënë nën kontroll. Komiteti thekson nevojën që autoritetet përkatëse të ndërmarrin veprime energjike shtesë, përfshi trajnimin në detyrë për të luftuar dukurinë e keqtrajtimit nga policia dhe rekomandon që të gjithë oficerëve të policisë t'iu rikujtohet se të gjitha format e keqtrajtimit të personave të ndaluar janë të papranueshme dhe se do t'iu nënshtrohen sanksioneve të rënda.

Lidhur me zbatimin në praktikë të garancive themelore ndaj keqtrajtimit (e drejta për të njoftuar një të afërm apo një palë të tretë për faktin e ndalimit dhe e drejta për të patur një avokat dhe vizitë mjeksore), situata duket se është përmirësuar që prej vizitës së fundit. Megjithatë, një numër personash të ndaluar u ankuan se nuk ishin lejuar të këshilloheshin me një avokat ose që ishin takuar me një avokat të caktuar *ex officio* për herë të parë vetëm pasi ishin marrë në pyetje nga një oficer policie.

Në disa prej komisariateve të policisë të vizituara, delegacioni konstatoi përmirësime të mëtejshme të kushteve të ndalimit. Veçanërisht, në Graçanicë, Leposaviq, Mitrovicë dhe Obiliq, qelitë në komisariatet e policisë ishin ndërtuar ose riparuar rishtazi dhe pjesa më e madhe e mangësive të vërejtura gjatë vizitave të mëparshme në komisariatet e tjera të policisë ishin korrigjuar. Megjithatë, në komisariatet e policisë në Pejë, ndriçimi artificial i qelive ishte shumë i dobët dhe, në disa prej komisariateve të vizituara qelitë nuk ishin të pajisura me një sistem komunikimi.

Institucionet e vuajtjes së dënimit

Krahasuar me konstatimet e bëra gjatë vizitës së vitit 2010, gjendja duket se është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme në shumicën e institucioneve të ShKK-së për sa i përket mënyrës së trajtimit të të burgosurve nga personeli. Veçanërisht, në burgun e Dubravës, delegacionit nuk iu paraqit asnjë akuzë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës gjatë kohëve të fundit nga pjesëtarët e grupit të posaçëm të ndërhyrjes të institucionit apo stafit të tij. Gjithashtu akuza nuk pati as në Qendrën e Riedukimit në Lipjan dhe në qendrat e vuajtjes së dënimit në Mitrovicë, Pejë dhe Prishtinë. Megjithatë, pati një sërë akuzash për keqtrajtim fizik si edhe kërcënime për rrahje nga oficerët e burgut në qendrën e vuajtjes së dënimit në Gjilan dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Krahasuar me situatën në vitin 2010, dhuna midis të burgosurve nuk u shfaq si një problem serioz në Burgun e Dubravës, as në institucionet e tjera të ShKK-së që u vizituan.

Megjithatë, KPT-ja shpreh shqetësim për mungesën e dukshme të përparimit në lidhje me trajtimin e dukurve të korruptionit dhe favorizimit në burgun e Dubravës, megjithë rekomandimet konkrete të bëra nga Komiteti pas dy vizitave të mëparshme. Vërtet, situata në këtë institucion, larg përmirësimit, dukej se ishte përkeqësuar më tej dhe delegacionit iu paraqitën akuza të shumta për korruption, që përfshinin jo vetëm stafin e burgut por edhe atë të kujdesit shëndetësor. Duket se, pasi paguanin mjaftueshëm, të burgosurit mund të merrnin kontrabandë (p.sh., telefona celulare apo drogë) ose trajtim preferencial lidhur me mundësitë e punësimit, vizitave familjare, lejeve të përkohshme për të dalë nga institucioni, trajtimin mjekësor, klasifikimit të sigurisë, etj. Gjithashtu raportohet se disa të burgosur kishin përfituar trajtime preferenciale falë lidhjeve të tyre familjare apo politike. Po ashtu, shqetësues është edhe fakti që një numër ankesash për praktika korruptive erdhën serish nga institucionet e vuajtjes së dënimit në Pejë dhe Prishtinë.

Kushtet materiale ndryshonin shumë mes institucioneve të ndryshme të ShKK-së. Në Qendrën e Riedukimit në Lipjan, kushtet për të gjithë të dënuarit mbeteshin përgjithësisht të përshtatshme, gjithashtu përmirësime u vunë re në burgun e Dubravës dhe në qendrën e vuajtjes së dënimit në Mitrovicë. KPT-ja mirëpret planet ekzistuese për mbylljen e qendrave të vuajtjes së dënimit në Gjiilan, Pejë dhe Prishtinë ku kushtet materiale janë përgjithësisht të këqija. Kushtet në Burgun e Sigurisë së Lartë janë përgjithësisht të mira, duke qenë se objekti është i ri. Megjithatë, burgu vuante nga një mangësi e madhe strukturore që ndikonte seriozisht në kushtet e përgjithshme të dënimit. Në fakt, shumica e hapësirave për ushtrimin e veprimtarive fizike, ngjitur me blloqet e dënimit, ishin ndërtuar në një terren me beton të bardhë, rrethuar nga një mur i lartë i të njëjtit material. Delegacioni dëgjoi një mori ankesash nga të burgosurit se pasqyrimi verbues i rrezeve të diellit në beton dhe mureve gjatë muajve të verës e bënte veprimtarinë fizike në ajër të pastër të vështirë edhe me syze dielli, dhe se sipërfaqja e ashpër e terrenit e bënte të rrezikshme çdo veprimtari fizike, përveç ecjes.

Ashtu si në vizitat e mëparshme, delegacioni pati përshtypje përgjithësisht të mirë në lidhje me regjimin që iu ofrohet grave dhe të miturve të burgosur si atyre të denuar ashtu edhe të padënuar) në Qendrën e Riedukimit në Lipjan. Në burgun e Dubravës, të burgosurit e dënuar mund të lëviznin lirish brenda hapësirës së vendit të dënimit gjatë ditës dhe iu lejohej dy deri në tre orë ushtrime në ajër të pastër. Rreth 350 të dënuar ishin angazhuar në punë dhe aktivitete të tjera. Përveç kësaj, tashmë kishte edhe punishte të mirëpajisura që sidoqoftë ishin në dispozicion të një numri të kufizuar të të burgosurish. Lidhur me qendrat e vuajtjes së dënimit të vizituara, KPT-ja vëren me kënaqësi se në Mitrovicë numri i të burgosurve të dënuar të angazhuar në punë ishte rritur që prej vizitës së fundit dhe se ishin ngritur dy punishte të reja. Po ashtu, Komiteti njeh përpjekjet e drejtuesve të qendrave të dënimit në Gjiilan e Pejë për të ofruar disa aktivitete sportive për të burgosurit e dënuar, pavarësisht kufizimeve infrastrukturore dhe të llojeve të tjera. Sa i përket Burgut të Sigurisë së Lartë, është pozitive që shumica e të burgosurve të dënuar kishin mundësi të kalonin nga gjashtë deri nëntë orë në ditë jashtë qelive të tyre. Megjithatë, shqetësim serioz përbën fakti që shumicës së të burgosurve nuk iu ofroheshin veprimtari të dobishme (si punë, arsimim, formim profesional apo veprimtari sportive).

Më tej, në burgun e Dubravës, në Burgun e Sigurisë së Lartë si dhe në qendra të tjera të vuajtjes së dënimit që u vizituan, regjimi për të burgosurit e padënuar mbetet përgjithësisht i varfër. Ashtu si në vitin 2010, përveç veprimtarive në ajër të pastër (dy deri në tre orë në ditë), shumica e të burgosurve të padënuar rrinin ende të mbyllur në qelitë e tyre gjatë pjesës më të madhe të ditës dhe nuk kishin ç' të bënin, përveçse të shihnin televizor, të lexonin apo të luanin lojëra tavoline.

KPT-ja vëren se në korrik të vitit 2013 përgjegjësia për kujdesin shëndetësor në burgje u transferua nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Në përgjithësi krahasuar me vizitën e vitit 2010, delegacioni vërejt një numër përmirësimesh lidhur me kujdesin shëndetësor që iu është ofruar të burgosurve. Ndërkohë buxheti për kujdesin shëndetësor në burgje është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit.

Pavarësisht nga kjo, burgu i Dubravës dhe qendra e vuajtjes së dënimit në Pejë përballeshin shpesh me ndërprerje të furnizimit me barna, përfshi ilaçe bazë si insulina, të cilën ndonjëherë pacientët ishin të detyruar ta blinin vetë. Më tej, KPT-ja shpreh shqetësim serioz lidhur me pamjaftueshmërinë e kujdesit psikiatrik që iu ofrohej pacientëve që vuanin nga çrregullime të rënda mendore në njësinë spitalore të burgut të Dubravës. Edhe pse vëren që në të gjitha institucionet e vizituara, të burgosurit e sapoardhur kontrolloheshin nga një mjek ose infermiere brenda 24 orëve nga pranimi i tyre, KPT-ja shpreh keqardhje për mungesën thuajse tërësore të zbatimit të rekomandimeve konkrete të bëra pas dy vizitave të mëparshme. Sidomos, me përjashtim të burgut të Dubravës dhe Burgut të Sigurisë së Lartë, nuk kishte ende asnjë ekzaminim sistematik fizik pas pranimit në asnjë nga institucionet e vizituara. Përveç kësaj, ekzaminimet/konsultat mjekësore shpesh kryheshin në praninë e oficerëve të burgut.

Më tej, KPT-ja ka hartuar një sërë rekomandimesh specifike lidhur me çështje të tjera që kanë të bëjnë me burgjet, si kontaktet e të burgosurve me botën e jashtme, disiplinën dhe sigurinë.

Instituti i Psikiatrisë Ligjore në Spitalin Universitar të Prishtinës (“Instituti i Psikiatrisë Ligjore”)

Delegacioni nuk dëgjoji asnjë akuzë dhe nuk gjeti asnjë tregues lidhur me keqtrajtimin e pacientëve nga personeli. Përkundrazi, atmosfera e përgjithshme dukej e qetë dhe marrëdhëniet midis personelit dhe pacientëve ishin pozitive.

Kushtet materiale në Institutin e Psikiatrisë Ligjore, i cili u hap në gusht të vitit 2014, ishin mjaft të mira në të gjitha drejtimet dhe numri i personelit ishte i mjaftueshme.

Instituti i Psikiatrisë Ligjore ofronte trajtim farmakologjik dhe psiko-social. Lidhur me miratimin e trajtimit, Komiteti thekson se shtrimi i pavullnetshëm i një personi në një institucion psikiatrik nuk duhet të përjashtojë miratimin e trajtimit pas marrjes së informacionit mbi të. Çdo pacient duhet informuar lidhur me trajtimin që synohet të bëhet dhe i duhet dhënë mundësia ta refuzojë ose tërheqë miratimin e trajtimit apo çdo ndërhyrje tjetër mjekësore. Çdo përjashtim nga ky parim themelor duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm me rrethana specifike të përcaktuara qartë dhe me rigorozitet.

Përdorimi i mjeteve shtrënguese (izolimi dhe kufizimet mekanike) ishte shumë i rrallë. Sidoqoftë, ekzistonin vetëm udhëzime të shkruara mjaft elementare mbi izolimin dhe asnjë udhëzim për përdorimin e mjeteve të tjera shtrënguese; përveç kësaj, nuk kishte një regjistër të plotë mbi rastet e përdorimit të mjeteve shtrënguese. KPT-ja rekomandon hartimin e udhëzimeve të hollësishme mbi bazën e kritereve të detajuara që parashtrihen në raport.

Më tej, Komiteti shpreh dyshimet e tij rreth faktit që personeli i infermierisë në Pavijonin B kryente rregullisht detyra që lidheshin me sigurinë, si kontrollet trupore dhe të qelive dhe se personeli privat i sigurisë (në Pavijonin B) dhe oficerët e ShKK-së (në Pavijonin C) thirrreshin, herë pas here nga personeli i infermierisë për t'i ndihmuar të merreshin me pacientët, edhe pse nuk ishin trajnuar për t'u angazhuar në veprime të tilla .

Klinika Psikiatrike në Spitalin Universitar të Prishtinës (“Klinika Psikiatrike”)

Delegacioni zhvilloi një vizitë të shkurtër në Pavijonin e Pranimet të Klinikës Psikiatrike, me qëllim që t'nihej me garancitë ligjore mbi shtrimin e pavullnetshëm me karakter civil në një institucion psikiatrik. Lidhur me këtë, KPT-ja vëren se Ligji për Procedurat Jokundërshtuese përmban një numër garancish të rëndësishme. Megjithatë, vizita nxori në pah se dispozitat përkatëse ligjore nuk ishin zbatuar asnjëherë në praktikë në Klinikën Psikiatrike. Veçanërisht, gjykatat nuk ishin informuar asnjëherë për shtrimet e pavullnetshme. Me fjalë të tjera, që prej vizitës së parë të KPT-së në vitin 2007, legjislacioni në fuqi mbetet një letër pa asnjë vlerë. Komiteti iu bën thirrje autoriteteve kompetente që t'i japin fund menjëherë kësaj situatë të papranueshme.